

## KRONIKE E ZEZE

Të shtënat me armë të martën pasdite në Podujevë ndodhën pas një përleshjeje mes dy familjeve, sipas Policisë së Kosovës. Tre persona mbetën të lënduar nga të shtënat, prej tyre dy kalimtarë të rastit. Dy të dyshuar janë arrestuar, ndërsa dy të tjerë janë ende në arrati.

Dy kalimtarëve të rastit iu shkaktuan lëndime trupore nga xhamat e thyer që u goditën nga plumbat.

Një person ka mbetur i plagosur nga të shtënat dhe ka vazhduar trajtimin mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Kalimtarëve të rastit, siç njofton Policia, u është ofruar ndihma mjekësore dhe më pas janë liruar për në shtëpi.

Për rastin, Policia deri tani ka arrestuar dy persona. Dy të tjerë janë në arrati.

“Me vendim të prokurorit të dyshuarve iu caktohet masa e ndalimit, njëri i dyshuar është dërguar në qendrën e mbajtjes ndërsa tjetri vazhdon trajtimin në QKUK nën sigurimin e policisë. Rasti vazhdon të hetohet nga njësitë kompetente policore”, thuhet në njoftimin 24-orësh të Policisë të mërkurën.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

## Komento

#PODUJEVĚ

#TË SHTËNA

26 tetor 2022, 09:20

Shpërndaje në



Arrestohet një serb në veri, i sekuestrohen "radiolidhje e pajisje ndihmëse për trazira"

82-vjeçari serb jep 50 euro  
ryshfet, arrestohet në Prizren  
bashkë me një zyrtar

Vdes një 63-vjeçar në Prizren, u godit nga kamioni teksa po lëvizte me biçikletë

Digjen disa baraka afër QKUK-së, s'ka të lënduar

7 vjet burgim pasi tentoi ta vriste ish-bashkëshorten, duke e therur me thikë tetë herë

Kërkohet paraburgim ndaj dy të dyshuarve për mashtrim e falsifikim të dokumenteve

Policia hap rast për dy persona që ilegalisht kanë prerë dru në Malet e Sharrit



TË TJERA

